

V E N D I M
Nr.141, datë 7.3.2003

**PËR PËRCAKTIMIN E PAGESËS VJETORE PËR MBAJTJEN E SË DREJTËS TË
SELEKSIONERIT TË BIMËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 27 të ligjit nr.8880, datë 15.4.2002 “Për të drejtat e seleksionerit të bimëve”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshillit i Ministrave

V E N D O S I:

1. Masa e pagesës vjetore për mbajtjen e së drejtës të seleksionerit të bimëve në regjistrin përkatës të jetë 4000 (katër mijë) lekë dhe për ndryshimin e përshkrimeve në regjistër të jetë 1 000 (një mijë) lekë.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano